

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.17. 01.2023*

17.01.2023  
Ora 14:18

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 16,  
paraqitur në KOZ në datën 19.12.2022”.*

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirja Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.  
**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. Erdal Mema, Znj. Kejsa Bici.  
**Të tjerë:** Z. Alfred Feto (FRD), KRIIK

**Z. E. Lako:** Atëherë, vazhdojmë seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe të Saksioneve me ankimin nr.16, “Për verifikimin e plotësimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes në lidhje me ankimin numër 16 të subjektit Fryma e Re Demokratike, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.224 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve””. Sipas shortit të hedhur, mbështetur në nenin 129 të Kodit Zgjedhor jam caktuar unë relator i kësaj çështjeje. Të pranishëm janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm, Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe përfaqësuesi i subjektit ankues që jeni?

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Alfred Feto.

**Z. E. Lako:** Palë të interesuara? Nuk ka, atëhere vazhdojmë me shqyrtimin. Duhet t’ju vë në dijeni se sot seanca ka të bëjë vetëm me plotësimin e elementëve të

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.17. 01.2023*


formës dhe të përmbajtjes së ankimit, pra nuk do ti hyjmë përmbajtjes, kështu që shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm, dy fjalë lidhur me plotësimin e formës dhe të përmbajtjes.

**Z. Y. Merhaj:** Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u shfaq Kërkesa Ankimore numër 16, me ankues Partia Fryma e Re Demokratike, e cila kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 224, dt. 07.12.2022 dhe pikërisht për pikën 21 të këtij vendimi, e cila e ka detyruar Partinë Fryma e Re Demokratike ti kthejë shumën prej 485.000 (katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, shumë e cila është bërë nga diferenca e pagës së marrë nga buxheti i shtetit. Gjatë verifikimit të kërkesës ankimore, konstatohet se ajo i përmbush elementët e formës dhe të përmbajtjes parashikuar në Nenin 26 të Kodit Zgjedhor dhe Nenit 130, pasi është kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit nga i KAS-i, ankuesi është legjitim për problemet financiare sa herë të kërkojnë faktet ligjore të ankimit, ju faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm! Ankuesi ka për të thënë gjë në lidhje me plotësimin e elementëve?

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Faleminderit, unë kam një eksperiencë shumë të gjatë si përfaqësues i partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ndërkohë që kam punuar edhe në Administratën Shtetërore për një kohë të gjatë, edhe kur nuk kishte diploma fallso dhe e di sesi referohet. Ju kërkoj ndjesë për ndonjë pasaktësi, pasi unë kam qenë rreth 3 muaj në Gjermani dhe këto që më kanë dhënë, ndoshta duke lënë pak mënjanë këtë thënien, kam bërë një trajnim të gjatë me NDI për zhvillimin e partive politike dhe të fushatës elektorale. Meqenëse jemi

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.17. 01.2023*

në këtë pikë po e theksoj. Gjatë fushatës elektorale është shumë e rëndësishme financa por duhet të them se si shumë parti të tjera dhe FRD-ja ka patur vështirësi të mëdha, për hir të konkurrencës, por edhe të disa ngjarjeve që të thëna ose të pathëna, të para ose të papara, të publikuara në televizione. Megjithatë po hyj në temë. Ankimimi i pikës 21 të vendimit nr. 224, dt. 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve...

**Z. E. Lako:** Ne do të shqyrtojmë sot nëse do ta kalojmë për shqyrtim apo jo? Keni ndonjë gjë për plotësimin e elementëve të formës? Pra, legjitimoheni, ka bazë ligjore, jemi ne Komisionin...

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Dakord, unë do të mbështetem tek një argument që paraqesim, megjithëse ju mund ta keni. Nëse e shihni të arsyeshme, mund ta lexoj, në të kundërt mund ta mbyllim këtu.

**Z. E. Lako:** Kur të kalojmë shqyrtimin në themel, do të shqyrtojmë provat, faktet dhe argumentat që keni ju për të. Sot do të diskutojmë, do ta shqyrtojmë apo jo?!

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Duhet shqyrtuar sepse mund të marr informacione edhe më të plota, do të jem edhe më i përgatitur.

**Z. E. Lako:** Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje?

**Z. I. Rusmali:** Jo nuk kemi pyetje.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.17. 01.2023*

**Z. E. Lako:** Dakord, atëherë KAS i konsultuar në vend duke vërejtur që plotësohen kërkesat e neneve 129, 130 të Kodit Zgjedhor vendosi: Kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim dhe caktimin e seancës në të cilën do të shqyrtohet thelbi, themeli i kësaj çështje, të hënën në datë 23 janar në orën 12:45, faleminderit e mbyllim këtu seancën.

**Vendimi nr. 4**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

